



This project is implemented by:

## THIRRJE PËR EKSPERTË/TE NË TEMËN PËRFAQSIM – AVOKIM

Inicjativa qytetare e femrave ANTIKO nga Shkupi, fton ekspertë/te, të interesuara, që posedojnë njohuri / ekspertizë/ dhe pervojë pune në përpunimin e temës „Përfaqesim publik /Avokim/. Eksperti/tja është paraparë të angazhohet në kuadër të projektit „Forca të bashkuara për interesa të përbashkëta“, financuar nga Bashkimi Evropian, dhe implementuar nga IQF ANTIKO dhe partnerët e projektit - COSV dega Prilep dhe CGI Prilep.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është : Forcimi i ndikimit të shoqërisë civile në promovimin e marrëdhënjëve ndëretnike , nëpërmjet të zhvillimit të demokracisë participative . Qëllimi specifik i projektit: mbështetje në ndërtimin e besimit ndërmjet komuniteteve, duke i promovuar interesat e përbashkëta dhe nxitjen e akcioneve lokale në proceset e vendimmarrjes; Forcimi i kapaciteteve të organizatave të sektorit civil për përfaqsim publik ( avokim)në bazë të dëshmiave/provave, si dhe, inicimi i bashkëpunimit dhe rrjetëzimit të tyre me vendimmarrësit nga institucionet relevante dhe palët e prekura (palët që kane interes). Aktivitetet e projektit do të zhvillohen në 12 komuna (6 në vitin e parë dhe 6 në vitin e dytë)

### Përshkrimi i detyrave

Eksperti/ja është paraparë të jetë i/e angazhuar gjatë një periudhe 2 vjeçare me këto detyra dhe obligime:

- Angazhim për pregaditjen dhe facilitimin e 2 trajnimeve treditore (gjithsej 6 ditë angazhim (3 ditë në vitin e parë dhe 3 ditë në vitin e dytë);
- Pjesëmarrje në aktivitetin „ Forume në komunitet” në 12 komuna ( 24 ditë angazhim - 12 ditë në vitin e parë në 6- komuna) dhe 12 ditë angazhim në vitin e dytë të realizimit të projektit (në 6- komuna tjera);
- Pjesëmarrje aktive në ekipin e ekspertëve(përbërë gjithsej nga 3- antar - ekspert ) – dhënja e përkrahjes në procesin e zhvillimit të plan-programit vjetor në 12 komuna
- Pjesëmarrës në trajnim do të jenë 48 përfaqësues të pushtetit lokal dhe përfaqësues të organizatave të sektorit civil në kohëzgjatje prej dy viteve ( gjithsej 24 përfaqësues-12 nga NJ.V.L. dhe 24 përfaqësues nga organizatat mentore që marrin pjesë në projektin).

Sipas projektit është paraparë në vitin e parë të realizohet një trajnim tre-ditor për 24 pjesëmarrës dhe e njejta të përsëritet vitin e ardhshëm për 24 pjesëmarrës të 6 komunave tjera.

Përmbajtja e trajnimit duhet të mbulojë temat kryesore në vijim : zhvillimi i ekspertizës dhe të fituarit njohuri në fushën përfaqësimit publik / Avokim:

- Përcaktimi i problemit;
- Njohja dhe identifikimi i interesit;
- Krijimi i ideve;
- Evaluimi i ideve;
- Vendimmarrje për një zgjidhje të mundshme ose kombinim të zgjidhjeve;
- Krijimi i planit për veprim.

Përmbajtja dhe vlersimi i trajnimeve duhet të jetë e realizuar nëpërmjet të metodologjisë përkatëse e adaptuar nevojave dhe nivelit të diturive paraprake të grupit të synuar në lidhje me temën.



Joint Forces for Common Interests!

This Project is Funded by the European Union!

Women's Civic Initiative ANTIKO Skopje

Vukovarska 23-1/2, P.O.Box 1090/1010

Phone: +389 2 2614 641 web: [www.antiko.org.mk](http://www.antiko.org.mk)

[contact@antiko.org.mk](mailto:contact@antiko.org.mk) and [antico@t.mk](http://antico@t.mk)



This project is implemented by:

Nga ekspertë që do të angazhohen pritet të sigurojë shkallë të lartë të interakcionit - përfshirjes aktive të pjesëmarrësve në aktivitetet, si dhe të shfrytëzojë mjete dhe forma të ndryshme të punës që do të mundësojnë arritjen e rezultateve të pritura, gjegjësisht avancimin e diturive, përvojave dhe aftësive të pjesëmarrësve.

Korniza kohore për angazhim :

Angazhimi i ekspertit/tes është paraparë të jetë në dy segmente:

1. 2 (Dy) trajnime dyditore të cilat do të realizohen në periudhë kohore :
  - 31.10 dhe 01-02.11.2016, në Ohër
  - Gusht – Tetor 2017, në Ohër
  - Nëntor –Dhjetor- 2016 dhe Janar 2017- „Forumet në komunitet”(12) dhe pjesëmarrje në stafin e ekspertëve - angazhim dhe mbështetje në procesin e zhvillimit të planit vjetor (6 komuna)
  - Viti i dyte „Forumet në komunitet”( 12) në 6 komuna tjera, si dhe pjesëmarrje në stafin e ekspertëve - angazhim dhe mbështetje në procesin e zhvillimit të planit vjetor
  - Koha e realizimit Nëntor –Dhjetor- 2017 dhe Janar 2018

Kontratë për konpenzim financiar

Angazhimi është i bazuar në kontrate pas kryerjes të një set aktivitetesh në nivel vjetor, gjegjësisht

- Në vitin e parë pagesa është paraparë të realizohet në Janar 2017, pasi të realizohet trajnimi i parë treditor dhe 12 ditë angazhim në „Forumet në Komunitet”, dhe pas pjesëmarrjes aktive në punën e stafit të ekspertëve gjegjësisht dhënjes së ekspertizës në procesin e zhvillimit të planeve vjetore.
- Për vitin e dytë, pagesa është paraparë të realizohet në Janar 2018, gjegjësisht pas realizimit të trajnimit triditor , 12 forumet në komunitet ( 6 komuna), dhe pas pjesëmarrjes aktive në punën e stafit të ekspertëve në procesin e zhvillimit të planit vjetor (ne 6 komuna tjera).
- Ekspertët duhet dorëzuar ofertë me kornizë finasiare e cila i përfshinë këto shpenzime:
  - ✓ Neto shuma për angazhim/ honorar;
  - ✓ Taksa personale
  - ✓ Shpenzimet e udhëtimit.

Projekti do të mbulojë kostot e akomodimit dhe ushqimit gjatë kohëzgjatjes së trajnimit.

Angazhimi përfshin edhe përgjegjësitë specifike të mëposhtme:

- ✓ Përgatitja e përmbajtjes së programi të trajnimit në bashkëpunim me ANTICO –n ;
- ✓ Realizimi i trajnimit;
- ✓ Vlerësimi( evaluimi ) i trajnimit;
- ✓ Përgatitja e një raporti përfundimtar që përfshin rezultatet e vlerësimit të trajnimit nga pjesëmarrësit, si dhe rekomandimet e mundshme për të ardhmen;

Kualifikimi i duhur

Ekspertët/tet duhet të kenë këto kualifikime dhe aftësitë :

- ✓ Diplomë Universitare;



Joint Forces for Common Interests!

This Project is Funded by the European Union!

Women's Civic Initiative ANTICO Skopje

Vukovarska 23-1/2, P.O.Box 1090/1010

Phone: +389 2 2614 641 web: [www.antiko.org.mk](http://www.antiko.org.mk)

[contact@antiko.org.mk](mailto:contact@antiko.org.mk) and [antico@t.mk](mailto:antico@t.mk)



This project is implemented by:

- ✓ Përvoj pune në sektorin civil, njohuri dhe përvojë në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e trajnimit të grupeve të ndryshme të synuara në temën Përfaqësim / Avokim (të paktën 5 vjet pune );
- ✓ Përvojë në pjesëmarrje , ndërmjetësim / facilitimi ( lehtësimi i procesit të mbajtjes se forumeve në komunitet;
- ✓ Ekspertiza në përgatitjen e programeve vjetore - planet e veprimit per OJQ dhe NJ.V.L.

#### Dokumentacioni i kërkuar

Oferta duhet të përmbajë si qëndron më poshtë:

- Propozim kornizë financiare e shprehur në euro;
- Draft Programi për trajnim;
- Biografi e detajuar ne lëminë përkatëse (CV);
- Letër motivimi;
- Lista Reference për përvojë në trajnimet , e cila përfshinë se ku është porositësi , tema përkatëse dhe grupet e synuara.

#### Kriteret për zgjedhje

Kriteret për përgjedhjen e trajnerëve:

- Pajtueshmëria e ofertës financiare buxhetin e paraparë - 40 pikë;
- Përvoja e mëparshme në zhvillimin dhe ofrimin e trajnimit - 35 pikë;
- Cilësia e projekt-programit të ofruar - 25 pikë.

#### Afati i dorëzimit të aplikacioneve

Aplikacionet dhe dokumentacioni i përgjithshëm i bashkangjitur me të gjitha dokumentet tjera përcjellëse duhet të dorëzohen jo më vonë se 7 tetor 2016 e-mail: [contact@antiko.org.mk](mailto:contact@antiko.org.mk) dhe [antico@t.mk](mailto:antico@t.mk).

Iniciativa qytetare e femrave ANTIKO



Joint Forces for Common Interests!

This Project is Funded by the European Union!

Women's Civic Initiative ANTIKO Skopje

Vukovarska 23-1/2, P.O.Box 1090/1010

Phone: +389 2 2614 641 web: [www.antiko.org.mk](http://www.antiko.org.mk)

[contact@antiko.org.mk](mailto:contact@antiko.org.mk) and [antico@t.mk](mailto:antico@t.mk)